KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4

Tiranë, Shqipëri

RAPORT FINAL

MBI AUDITIMIN E EKSTRAKTEVE TË PËRBËRËSVE ZGJEDHORË

PËR ZGJEDHJET VENDORE 2019

Përgatitur nga: Ing.Lorenc Bako

Audit Teknicien

Tiranë më 1 Qeshor 2019

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

I nderuar z.Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në zbatim të vendimit Nr. 38, datë 26.12.2018, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për emërimin e auditit teknicien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qeshor 2019" dhe udhëzimit Nr.2, datë 28.12.2012 të KQZ "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknicien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe në sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV), ju paraqes më poshtë raportin Final të auditimit të kryer për periudhën zgjedhjet vendore 2019.

Në këtë raport jepen vlerësimet dhe rekomandimet për veprimet e kryera mbi bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile duke analizuar ekstraktet e përbërësve zgjedhore dhe listat e zgjedhësve të gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile(RKGJC) në zbatim të "Kodit Zgjedhor", Ligjit "Për Gjendjen Civile" dhe akteve të mëposhtëme nënligjore:

- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.295/1, datë 06.11.2018 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore"
- Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike".
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile"

Përmbajtja

Hyrje 4

Baza ligjore e auditimit 4

Metodologjia e Auditimit 5

Gjetje dhe opinion 7

Rekomandime 9

Statistika 10

1. **Numri i përgjithshëm i zgjedhësve në lista** 10
2. **Numri i qendrave të votimit (QV)** 11
3. **Numri i personave të dyshuar të dublikuar në lista** 12
4. **Numri i zgjedhësve mbi 100 vjeç të papërfshire në lista** 13
5. **Numri i zgjedhësve me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999** 14
6. **Numri i zgjedhësve të pezulluar nga listat për shkak të kufizimeve ligjore** 15

Aneks 1 16

Aneks 2 18

Aneks 3 20

Aneks 4 22

Aneks 5 24

Hyrje

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, sipas dekretit Nr.10928 të Presidentit të Republikës, datë 05.11.2018, do të zhvillohen më datë 30 qeshor 2019. Pas krijimit të përvojës së parë në zgjedhjet e datës 21 Qeshor 2015 për organet e qeverisjes vendore, të bazuara mbi ndarjen e re Administrativo-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore, këto zgjedhje pritet të jenë më të konsoliduara dhe me problematike më të ulët përsa i perket informacionit të gjeneruar nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.
Këto zgjedhje vijnë në një kohë mjaft kritike për ecurinë e Shqipërisë në procesin e anëtarësimit në BE, dhe në të njëjtën fashë kohore me pritjen e vendimit për hapjen e negociatave për antarësim.

Baza ligjore e auditimit

- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin Nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin Nr.31/2015, datë 02.04.2015
- Ligji Nr.10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar me ligjin Nr.6/2012, datë 02.02.2012, ligjin Nr.130/2013 datë 25.04.2013, ligjin Nr.134/2016 datë 22.12.2016 dhe ligjin Nr.69/2018 datë 11.10.2018.
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore"

- Vendimi i KM Nr.365, datë 11.6.2004 "Për krijimin e mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik".
- Vendimi i KM Nr.673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar me Vendimin e KM Nr.36, datë 24.01.2018, Vendimin e KM Nr.88, datë 14.02.2018 dhe Vendimin e KM Nr.448, datë 26.07.2018.

- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.295/1, datë 06.11.2018 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore".
- Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë denimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike".
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".
- Udhëzimit të KQZ-së Nr.2, datë 28.12.2012 "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditet tekniciene për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe ne sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV)

Metodologjia e Auditimit

Përgjegjësia e audituesit është që të verifikojë përputhshmërinë e veprimeve të kryera nga DPGJC me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, Ligjin për "Gjendjen Civile" dhe aktet e nxjerra në zbatim të tyre nga KQZ-ja dhe Ministri i Brendshëm, mbi bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile nga fillimi i procesit deri në shpalljen e listave përfundimtare të zgjedhësve. Listat e zgjedhësve "janë dokumente zyrtare të zgjedhësve, që burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për çdo zonë të qendrës së votimit, të hartuara në përputhje me këtë Kodin Zgjedhor". Auditimi për përbërësit zgjedhorë në kuptimin që ka dhënë Kodi Zgjedhor në nenin 45 nënkupton auditimin për përbërësit e gjendjes civile si më poshtë:

a) Emri
b) Atësia
c) Amësia
d) Mbiemri
e) Datëlindja
f) Numri Personal i Identifikimit
g) Shtetësia
h) Kodi i Vendbanimit
i) Gjinia

Auditimi është kryer mbi parimin e prezumimit të vërtetësisë së të dhënave të vëna në dispozicion nepërmjet:

1. Informacioni zyrtar publik nga Ekstrakti i Parë i Përbërësve Zgjedhorë (4 Dhjetor 2018), Ekstrakti i Dytë i Përbërësve Zgjedhorë (3 Janar 2019) , Ekstrakti i Tretë i Përbërësve Zgjedhorë (1 Shkurt 2019) dhe Ekstrakti i Katërt i Përbërësve Zgjedhorë (2 Mars 2019), Ekstrakti i Pestë i Përbërësve Zgjedhorë (29 Mars 2019), Ekstrakti i Gjashtë i Përbërësve Zgjedhorë (28 Prill 2019) dhe Lista Përfundimtare (21 Maj 2019) të publikuar *online*.
2. Informacioni zyrtar jopublik mundësuar në bashkëpunim me personelin e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, ekstraktuar drejtpërdrejt nga baza e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile nëpërmjet aksesit në një kompjuter të lidhur ne rrjetin GovNet të instaluar pranë zyrave të DPGJC. **Theksoj që aksesi në këtë kompjuter për username të përdorur për auditim kishte vetëm të drejta leximi (Read-Only) dhe jo konsultimi apo ndryshimi, me të njejtin akses që ka edhe Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile.**

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të këtij auditimi janë kryer verifikime/testime të bazuara në kontrollet mbi ekstraktet përkatës si dhe RKGJC, duke filtruar fushat /rekordet përkatës në bazë të përcaktimeve ligjorë në fuqi.

Janë analizuar në mënyrë indirekte veprimet në bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile nëpërmjet krahasimit relacional të përmbajtjes respektive të ekstrakteve zyrtare.

Teknikisht filtrimet janë kryer me "SQL queries" (Structured Query Languages) në Microsoft SQL Server mbi databazat/tabelat përkatëse.

Verifikimi i dublimeve është kryer mbi bazën e testimit me metoden e krahasimit dhe të ngjashmërisë së rubrikave të përbërësve zgjedhore nëpërmjet 19 përkëmbimesh sipas aneksit nr.1 të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".

Dëshiroj të theksoj gjithashtu që gjatë kësaj periudhe, të gjitha kërkimet me teknikat e mësipërme janë kryer në orare jashtë "pikut" të punës të RKGJC për shak të ngarkesës së këtij sistemi në procesimin e kërkesave për pajisjen e shtetasve me karta identiteti biometrike dhe pashaporta biometrike pasi kjo periudhë përkon me rinovimin e këtyre dokumentave për një numër shumë të madh qytetarësh.

Gjetje dhe opinion

Pas vlerësimit të të gjithë informacionit publik dhe jo publik të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe bazuar në verifikimet direkte dhe indirekte në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, duke analizuar gjashte ekstraktet të përbërësve zgjedhore të gjeneruara dhe Listës perfundimtare të zgjedhësve, në përmbushje të detyrës së ngarkuar dhe në zbatim të legjislacionnit në fuqi jap opinionin tim si me poshtë.
Janë zbatuar përgjithësisht procedurat në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.295/1, datë 06.11.2018 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore" , të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike" dhe të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".

- Sipas pikës 1 të nenit 47 të Kodit Zgjedhor, Lista e zgjedhësve nxirret nga RKGJC-ja, e cila nënkupton që sa më i saktë dhe i konsoliduar të jetë RKGJC-ja aq më të sakta janë listat zgjedhore. Në këtë këndvështrim duhet theksuar se RKGJC është regjistri më i saktë dhe më i konsoliduar nga pikëpamja software dhe hardware por edhe i sigurisë njëkohësisht. Vlen të theksohet gjithashtu se një nga pikat e dobta që u evidentuan në raportet e mëparshme, e cila lidhej me mirëmbajtjen e këtij regjistri, është zgjidhur me realizimin e mirëmbajtjes me kompaninë austriake XION e cila ka implementuar RKGJC, gjë që do të çojë në rritjen e performancës dhe të sigurisë të këtij sistemi kompjuterik.

- Janë gjeneruar brenda afateve ligjore në respekt të pikave 5 dhe7, të nenit 51 të Kodit Zgjedhor, gjashtë ekstrakte të përbërësve zgjedhore dhe lista përfundimtare, ekstrakti i parë më datë 4 Dhjetor 2018, ekstrakti i dytë më datë 3 Janar 2019, ekstrakti i tretë më datë 1 Shkurt 2019, ekstrakti i katërt më 2 Mars 2019, ekstrakti i pestë më 29 Mars 2019, ekstrakti i gjashtë me 28 Prill 2019 dhe Lista përfundimtare më 21 Maj 2019.

- Është publikuar online lista e zgjedhësve në faqen zyrtare të KQZ dhe të Ministrisë së brendshme të cilat pointojnë në adresën: http://134.0.58.65/votinglistapp/ sipas përcaktimeve të pikës 5 të nenit 51 të Kodit Zgjedhor.

- Një nga problematikat më të mëdha në zgjedhjet e kaluara, si ato të përgjithshme dhe ato vendore, ka qenë numri i zgjedhësve me kod vendbanimi të panjohur ku sipas ekstraktit të parë ky numër ka qenë **284.065** zgjedhës ndërsa në listën përfundimtare rezulton të jetë vetëm 727 zgjedhës. Me këtë veprim i cili është kryer në koordinim midis DPGJC , Zyrave të gjendjes civile dhe drejtuesve të njësive të pushtetit vendor, është eleminuar njëherë e përgjithmonë një nga problematikat për zgjedhjet e ardhshme.

- Numri i zgjedhësve të dyshuar si dublikime nga ekstrakti i parë deri ne listën përfundimtar ka ndryshuar nga 5679 në 453 brenda njësive administrative dhe nga 1795 në 13 jashtë njësive administrative.

- Përsa i përket numrit të qendrave të votimit jashtë kritereve ligjore, në zbatim të pikës 2 të nenit nr.46 të Kodit Zgjedhor (nën 200 ose mbi 1000 zgjedhës për një qendër votimi) në listen përfundimtare ky numër është **Zero**, ashtu si ishte shprehur në raportet e mëparshme se do të ndodhte. Vlen të theksohet se se të gjitha këto qendra votimi jashtë kritereve ligjore, të pasqyruara në raportet e mëparshme, asnjëherë nuk kanë qenë pjesë e listave të publikuara sipas pikes 4 të nenit 51 të kodit zgjedhor.

- Vihet re që përgjatë gjashtë ekstrakteve numri i personave mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista ka ardhur duke u ulur, por në listën përfundimtare të zgjedhësve ky numër është dyfishuar. Kjo ka ndodhur për faktin sepse deri në periudhën përpara se të kryhej kontrata e mirëmbajtjes me kompaninë XION, kodet 8899 për këtë kategori zgjedhësish janë ndryshuar manualisht nga zyrat e gjendjes civile, proces ky i cili ka shkaktuar mosreflektimin e sakte të këtij grupi zgjedhësish. Në listen përfundimtare me ndihmën e kompanisë së suportit, është mundësuar ndryshimi automatik i kodit të QV, konkretisht në kodin '8899', për ata shtetas që mbushin ose kalojne moshën 100 vjeç, deri më datë 30.06.2019

- Një nga problematikat e vëna re në hartimin e listave në këto zgjedhje por edhe duke parë relacionet për zgjedhjet e mëparshme, është evidentimi i zgjedhësve të cilët janë pezulluar nga lista e zgjedhësve për arsye të zbatimit të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike". Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bazë të këtij udhëzimi duhet të dërgojë brenda afateve pranë DPGJC listat e këtyre zgjedhësve, pasi në varësi të numrit të tyre mund të ndryshojë edhe konfigurimi i numrit të qendrave të votimit. Pavarësisht këtij problem organizativ janë hequr nga lista përfundimtare e zgjedhësve të gjithë ata shtetas që preken nga ky udhëzim.

- Janë përcakttuar gjithashtu 19 qendra votimi me zgjedhësit përkatës për Institucionet e Posaçme sipas afateve ligjore sipas listës në Aneks 5.

Rekomandime

Bazuar në auditimin e kryer për përiudhën Dhjetor 2018 – Maj 2019, gjatë së cilës janë gjeneruar gjashtë ekstrakte të përbërësve zgjedhore dhe Lista përfundimtare e zgjedhësve rekomandoj që:

1. Në mënyrë që mos të këtë më qendra votimi me numër zgjedhësish jashtë kritereve ligjore dhe duke marrë parasysh që është realizuar kontrata e mirëmbajtjes për RKGJC nga DPGJC-ja, sugjeroj që të kryhen ndryshime në sistemin informatik qendror të DPGJC në mënyrë që punonjësit e zyrave të gjendjes civile mos të munden që një zgjedhësi t'í vendosin një numër QV-je e cila është:
   - Jashtë përcaktimeve ligjore
   - Nuk është aktive (pa votues)
   - Ka numër të ndryshëm nga udhëzimet në fuqi për përcaktimin e numrit të QV-së për rastet specifike (psh.8899 ose 7788)

   Gjithashtu rekomandohet që po në sistem të kryhen ndryshime për të detyruar që:

   - Nëse ndryshon një nga fushat "numban", "adresa", "komuna/bashkia", "FamilyID" apo "zyra e gjendjes civile", do të duhet të konfirmohet edhe numri i QV-së
   - Nëse ndryshon fusha "bashkia" apo "zyra e gjendjes civile" të ndryshojë edhe numri QV-së duke qenë i ndryshëm nga i mëparshmi.

2. Të kryhet përmirësimi i bazës ligjore, praktikisht VKM Nr.365, datë 11.6.2004 "Për krijimin e mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik" në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore".

3. Të vijojë puna e vazhdueshme e DPGJC për eleminimin e shtetasve të dyshuar si të dublikuar brenda RKGJC edhe gjatë periudhës jozgjedhore nëpërmjet implementimit të funksioneve periodikë brenda sistemit informatik të cilat të bazohen në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.370, datë 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".

Statistika

Në bazë të ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë të gjeneruara në datat 4 Dhjetor 2018, 3 Janar 2019, 1 Shkurt 2019, 2 Mars 2019, 29 Mars 2019, 28 Prill 2019 dhe Listës përfundimtare të zgjedhësve me 21 Maj 2019, kemi si më poshtë :

1. Numri i përgjithshëm i zgjedhësve në lista

Është bërë kontrolli duke gjeneruar nga RKGJC listën për të gjithë ata shtetas të cilët janë zgjedhës sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin Nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin Nr.31/2015, datë 02.04.2015.

- Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **3,549,909** zgjedhës.
- Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **3,547,688** zgjedhës.
- Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultuan gjithsej **3,545,025** zgjedhës.
- Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultuan gjithsej **3,543,471** zgjedhës.
- Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **3,540,413** zgjedhës.
- Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **3,538,511** zgjedhës.
- Në Listën Përfundimtare të datës **21 Maj 2019** rezultojnë **3,536,015** zgjedhës.

Nga të cilët :

- Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan **1,795,786** zgjedhës meshkuj dhe **1,754,123** zgjedhës femra.
- Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan **1,794,577** zgjedhës meshkuj dhe **1,753,111** zgjedhës femra.
- Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultuan **1,793,024** zgjedhës meshkuj dhe **1,752,004** zgjedhës femra.
- Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultuan **1,791,542** zgjedhës meshkuj dhe **1,751,929** zgjedhës femra.
- Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan **1,790,283** zgjedhës meshkuj dhe **1,750,130** zgjedhës femra.
- Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan **1,789,433** zgjedhës meshkuj dhe **1,749,078** zgjedhës femra.
- Në Listën Përfundimtare të datës **21 Maj 2019** rezultojnë **1,786,444** zgjedhës meshkuj dhe **1,749,571** zgjedhës femra.

Nga krahasimi i ekstraktit të fundit dhe Listës Përfundimtare vihet re një diferencë (ulje e numrit) prej **2496** zgjedhësish e cila vjen si pasojë e reflektimit të numrit të vdekjeve gjatë periudhës midis dy ekstrakteve, nga reflektimet e prapambetura për fundin e vitit 2018 që janë në vazhdim si dhe nga verifikimi i dublimeve.

Gjithashtu në Aneks-in I që shoqëron këtë raport jepet edhe numri i zgjedhësve të papërfshirë në lista për shak të kufizimit ligjor (më pak se 200 dhe me shumë se 1000 zgjedhës) për secilin nga ekstraktet. Ky numër bëhet Zero në Listën Përfundimtare

- Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **352,355** zgjedhës.
- Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **173,526** zgjedhës.
- Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultuan gjithsej **66,072** zgjedhës.
- Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultuan gjithsej **41,645** zgjedhës.
- Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **15,254** zgjedhës.
- Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **11,934** zgjedhës.
- Në Listën Përfundimtare të datës **21 Maj 2019** rezultojnë **0 (Zero)** zgjedhës.

Ashtu si është sqaruar në raportet e mëparshme, ky numër shkon në zero gjatë procesit të vendosjes dhe sistemimimit të të gjitha qendrave të votimit me numër zgjedhësish brenda limiteve ligjore.

2. Numri i qendrave të votimit (QV)

Nga kontrolli dhe verifikimi i gjashtë ekstrakteve të datës 4 Dhjetor 2018, 3 Janar 2019, 1 Shkurt 2019, 2 Mars 2019, 29 Mars 2019, 28 Prill 2019 dhe Lista Përfundimtare më 21 Maj 2019 rezulton:

- Numri i përgjithshëm i qendrave të votimit me numër zgjedhësish brenda përcaktimeve ligjore (200-1000 zgjedhës) eshtë:

  - Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **5,011** QV.
  - Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **5196** QV.
  - Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultojnë gjithsej **5348** QV.
  - Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultojnë gjithsej **5368** QV.
  - Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **5392** QV.
  - Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **5397** QV.
  - Në Listën Përfundimtare të datës **21 Maj 2019** rezultojnë **5417** QV.

- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish mbi 1,000 është:

  - Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **310** QV.
  - Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **149** QV.
  - Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultojnë gjithsej **57** QV
  - Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultojnë gjithsej **34** QV.
  - Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **10** QV.
  - Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **8** QV.
  - Në Listën Përfundimtare të datës **21 Maj 2019** rezultojnë **0 (Zero)** QV.

- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish 20-200 është :

  - Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **44** QV.
  - Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **38** QV.
  - Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultojnë gjithsej **33** QV.
  - Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultojnë gjithsej **25** QV.
  - Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **26** QV.
  - Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **22** QV.
  - Në Listën Përfundimtare të datës **21 Maj 2019** rezultojnë **0 (Zero)** QV.

- Numri i qendrave të votimit me numër zgjedhësish nën 20 është:

  - Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **675** QV.
  - Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **291** QV.
  - Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultojnë gjithsej **261** QV
  - Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultojnë gjithsej **117** QV.
  - Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **102** QV.
  - Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **87** QV.
  - Në Listën Përfundimtare të datës **21 Maj 2019** rezultojnë **0 (Zero)** QV.

3. Numri i personave të dyshuar të dublikuar në lista

Nga kontrolli dhe verifikimi i listave në lidhje me numrin potencial të dublimeve, bazuar mbi Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile", rezulton se:

- Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **5679** zgjedhës të dyshuar si të dubluar brenda njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **1795** zgjedhës të dyshuar si të dubluar jashtë njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **570** zgjedhës të dyshuar si të dubluar brenda njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **30** zgjedhës të dyshuar si të dubluar jashtë njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultuan gjithsej **565** zgjedhës të dyshuar si të dubluar brenda njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultuan gjithsej **26** zgjedhës të dyshuar si të dubluar jashtë njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultuan gjithsej **565** zgjedhës të dyshuar si të dubluar brenda njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultuan gjithsej **26** zgjedhës të dyshuar si të dubluar jashtë njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **512** zgjedhës të dyshuar si të dubluar brenda njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **21** zgjedhës të dyshuar si të dubluar jashtë njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **478** zgjedhës të dyshuar si të dubluar brenda njësive administrative.
- Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **18** zgjedhës të dyshuar si të dubluar jashtë njësive administrative.
- Në Listën Përfundimtare të dates **21 Maj 2019** rezultojnë gjithsej **453** zgjedhës të dyshuar si të dubluar brenda njësive administrative.
- Në Listën Përfundimtare të dates **21 Maj 2019** rezultojnë gjithsej **13** zgjedhës të dyshuar si të dubluar jashtë njësive administrative.

4. Numri i zgjedhësve mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista rezulton:

- Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **1309** zgjedhës mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista.
- Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **1255** zgjedhës mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista.
- Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultuan gjithsej **1214** zgjedhës mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista.
- Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultuan gjithsej **1101** zgjedhës mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista.

- Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **1077** zgjedhës mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista.
- Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **1087** zgjedhës mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista.
- Në Listën Përfundimtare të datës **21 Maj 2019** rezultojnë gjithsej **2797** zgjedhës mbi 100 vjeç të papërfshirë në lista.

Lista e shpërndarjes së shtetasve që i përkasin kësaj kategorie jepet bashkëngjitur këtij raporti në **Aneks 2.**

5. Numri i zgjedhësve me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999

Përsa i përket numrit të zgjedhësve me kod vendbanimi të papërcaktuar procesi i eleminimit të këtyre zgjedhësve ka shkuar në renie edhe në ekstraktin e fundit dhe në Listën përfundimtare. Ky përmirësim ka ardhur si pasojë e një bashkëpunimi dhe koordinimi shume të mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Njësive të Qeverisjes Vendore. Për pasojë për gjashtë ekstraktet e gjeneruara dhe Listën Përfundimtare kemi:

- Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **284,065** zgjedhës me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999.
- Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **217,961** zgjedhës me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999.
- Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultuan gjithsej **54,365** zgjedhës me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999.
- Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultuan gjithsej **3,609** zgjedhës me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999.
- Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **3,048** zgjedhës me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999.
- Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **841** zgjedhës me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999.
- Në Listën Përfundimtare të datës **21 Maj 2019** rezultojnë gjithsej **727** zgjedhës me kod vendbanimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton një përmirësim i numrit të këtyre zgjedhësve midis ekstraktit të parë dhe listës përfundimtare me **283,338** zgjedhës. Duhet të kihet parasysh që ky ka qenë një prej problemeve të vërejtura në zgjedhjet e vitit 2015 dhe 2017 ku këto shifra kanë qenë përkatësisht **300,506** dhe **290,038** zgjedhës dhe përmirësimi në uljen e numrit të këtyre zgjedhësve është i dukshëm dhe kjo problematike mund te quhet si e ezauruar për proceset e ardhshme zgjedhore. Statistikat në lidhje me shperndarjen e këtyre zgjedhësve të ndarë sipas qarqeve dhe bashkive jepen në **Aneks 3.**

6. Numri i zgjedhësve të pezulluar nga listat për shkak të kufizimeve ligjore.

Në këtë kategori bëjnë pjesë ata zgjedhës të cilët janë pezulluar nga lista e zgjedhësve për arsye të zbatimit të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike". Nga kontrolli dhe verifikimi i gjashtë ekstrakteve dhe listës përfundimtare rezulton se:

- Në ekstraktin e datës **4 Dhjetor 2018** rezultuan gjithsej **1,264** zgjedhës të papërfshirë në lista.
- Në ekstraktin e datës **3 Janar 2019** rezultuan gjithsej **1,252** zgjedhës të papërfshirë në lista.
- Në ekstraktin e datës **1 Shkurt 2019** rezultuan gjithsej **1,231** zgjedhës të papërfshirë në lista.
- Në ekstraktin e datës **2 Mars 2019** rezultuan gjithsej **1,196** zgjedhës të papërfshirë në lista.
- Në ekstraktin e datës **29 Mars 2019** rezultuan gjithsej **1,191** zgjedhës të papërfshirë në lista.
- Në ekstraktin e datës **28 Prill 2019** rezultuan gjithsej **1,152** zgjedhës të papërfshirë në lista.
- Në Listën Përfundimtare të datës **21 Maj 2019** rezultojnë gjithsej **1,114** zgjedhës të papërfshirë në lista.

Për reflektimin dhe përmirësimin e numrit të këtyre shtetasve do të duhet një bashkëpunim dhe koordinim më i mirë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
Statistikat në lidhje me shperndarjen e këtyre zgjedhësve të ndarë sipas qarqeve dhe bashkive jepen në **Aneks 4.**

Një përmbledhje e statistikave kryesore të evidentuara gjatë auditimit të dy ekstrakteve zgjedhore jepet në **Aneks-in I**, bashkëngjitur këtij raporti.

Aneks 1

Përbërësit zgjedhorë	Ekstrakti Përfundimtar 2017	Ekstrakti 4 dhjetor 2018	Ekstrakti 3 Janar 2019	Ekstrakti 1 Shkurt 2019	Ekstrakti 2 Mars 2019	Ekstrakti 29 Mars 2019	Ekstrakti 28 Prill 2019	Lista Përfundimtare 21 Maj 2019
Numri i përgjithshëm qendrave të votimit	**5361 QV**	**5011 QV**	**5196 QV**	**5348 QV**	**5368 QV**	**5392**	**5397**	**5417**
Numri i Qendrave të Votimit mbi limitin (1000 zgjedhës)	**0**	**310 QV**	**149 QV**	**57 QV**	**34QV**	**10**	**8**	**0**
Numri i Qendrave të Votimit nën limitin (20 - 200 zgjedhës)	**0**	**44 QV**	**38 QV**	**33 QV**	**25QV**	**26**	**22**	**0**
Numri i Qendrave të Votimit nga 1 deri në 20 zgjedhës	**0**	**675 QV**	**291 QV**	**261 QV**	**117QV**	**102**	**87**	**0**
Numri i personave të dyshuar të dublikuar në lista brenda njësive administrative	**N/A**	**5679**	**570**	**565**	**565**	**512**	**478**	**453**
Numri i personave të dyshuar të dublikuar në lista jashtë njësive administrative	**459**	**1795**	**30**	**26**	**26**	**21**	**18**	**13**
Numri i shtetasve 100 vjec të pa përfshirë në lista	**1489**	**1309**	**1255**	**1232**	**1101**	**1077**	**1087**	**2797**
Numri i zgjedhësve të pezulluar nga listat për shkak të kufizimeve ligjore	**1371**	**1,264**	**1,252**	**1,231**	**1,196**	**1,191**	**1,152**	**1,114**

Numri i zgjedhësve me adresë banimi të papërcaktuar 000,888 dhe 999	**290,038**	**284,065**	**217,961**	**54,365**	**3,609**	**3,048**	**841**	**727**
Numri i zgjedhësve në total të perfshirë në lista	**3,452,308**	**3,197,554**	**3,374,162**	**3,478,956**	**3,501,826**	**3,525,159**	**3,526,577**	**3,536,015**
Numri i zgjedhësve meshkuj		**1,795,786**	**1,794,577**	**1,793,024**	**1,791,542**	**1,790,283**	**1,789,433**	**1,786,444**
Numri i zgjedhësve femra		**1,754,123**	**1,753,111**	**1,752,004**	**1,751,929**	**1,750,130**	**1,749,078**	**1,749,571**
Numri i zgjedhësve të pa perfshire në lista (për shkak të qendrave jashtë kritereve ligjore)	**0**	**352,355**	**173,526**	**66,072**	**41,645**	**15,254**	**11,934**	**-**
Numri total i zgjedhësve	**3,451,896**	**3,549,909**	**3,547,688**	**3,545,028**	**3,543,471**	**3,540,413**	**3,538,511**	**3,536,015**

Aneks 2

Lista e shpërndarjes së shtetasve mbi 100 vjec të pa përfshirë në lista

Emër Qarku	Emër Bashkia	Numri
Elbasan	Bashkia Belsh	10
Berat	Bashkia Berat	41
Diber	Bashkia Bulqizë	27
Elbasan	Bashkia Cërrik	18
Vlore	Bashkia Delvinë	3
Korce	Bashkia Devoll	80
Diber	Bashkia Dibër	31
Fier	Bashkia Divjake	19
Gjirokaster	Bashkia Dropull	299
Durres	Bashkia Durrës	86
Elbasan	Bashkia Elbasan	43
Fier	Bashkia Fier	45
Vlore	Bashkia Finiq	139
Shkoder	Bashkia Fushë - Arrëz	38
Gjirokaster	Bashkia Gjirokastër	40
Elbasan	Bashkia Gramsh	18
Kukes	Bashkia Has	26
Vlore	Bashkia Himarë	126
Tirane	Bashkia Kamëz	44
Tirane	Bashkia Kavajë	13
Gjirokaster	Bashkia Kelcyre	21
Diber	Bashkia Klos	23
Korce	Bashkia Kolonjë	25
Vlore	Bashkia Konispol	15
Korce	Bashkia Korçë	205
Durres	Bashkia Krujë	33
Berat	Bashkia Kuçovë	11
Kukes	Bashkia Kukës	69
Lezhe	Bashkia Kurbin	25
Lezhe	Bashkia Lezhë	35

Gjirokaster	Bashkia Libohove	26
Elbasan	Bashkia Librazhd	19
Fier	Bashkia Lushnje	11
Shkoder	Bashkia Malësi e Madhe	81
Korce	Bashkia Maliq	39
Fier	Bashkia Mallakaster	11
Diber	Bashkia Mat	23
Gjirokaster	Bashkia Memaliaj	12
Lezhe	Bashkia Mirditë	21
Fier	Bashkia Patos	13
Elbasan	Bashkia Peqin	3
Gjirokaster	Bashkia Përmet	24
Korce	Bashkia Pogradec	32
Berat	Bashkia Poliçan	4
Elbasan	Bashkia Prrenjas	5
Shkoder	Bashkia Pukë	23
Korce	Bashkia Pustec	37
Tirane	Bashkia Rrogozhinë	16
Fier	Bashkia Rroskovec	9
Vlore	Bashkia Sarandë	16
Vlore	Bashkia Selenicë	27
Durres	Bashkia Shijak	9
Shkoder	Bashkia Shkodër	140
Berat	Bashkia Skrapar	15
Gjirokaster	Bashkia Tepelenë	3
Tirane	Bashkia Tiranë	406
Kukes	Bashkia Tropojë	70
Berat	Bashkia Ura Vajgurore	14
Shkoder	Bashkia Vau i Dejës	14
Vlore	Bashkia Vlorë	57
Tirane	Bashkia Vorë	9
	TOTAL	**2797**

Aneks 3

Statistikat për zgjedhësit me kod vendbanimi të papërcaktuar

Qarku	Bashkia	Numër
Berat	Bashkia Berat	1
Diber	Bashkia Dibër	1
Diber	Bashkia Mat	1
Diber	Bashkia Mat	1
Diber	Bashkia Mat	18
Durres	Bashkia Durrës	1
Durres	Bashkia Durrës	4
Durres	Bashkia Durrës	6
Elbasan	Bashkia Cërrik	1
Elbasan	Bashkia Elbasan	1
Elbasan	Bashkia Peqin	1
Elbasan	Bashkia Librazhd	3
Fier	Bashkia Fier	1
Fier	Bashkia Lushnje	4
Gjirokaster	Bashkia Gjirokastër	1
Gjirokaster	Bashkia Gjirokastër	1
Gjirokaster	Bashkia Tepelenë	6
Gjirokaster	Bashkia Përmet	22
Gjirokaster	Bashkia Përmet	3
Korce	Bashkia Korçë	1
Korce	Bashkia Pogradec	4
Kukes	Bashkia Kukës	2
Kukes	Bashkia Kukës	4
Kukes	Bashkia Kukës	1
Kukes	Bashkia Has	9
Lezhe	Bashkia Mirditë	1
Lezhe	Bashkia Kurbin	27
Shkoder	Bashkia Fushë - Arrëz	1
Shkoder	Bashkia Fushë - Arrëz	341
Shkoder	Bashkia Pukë	1

Shkoder	Bashkia Malësi e Madhe	94
Shkoder	Bashkia Malësi e Madhe	1
Shkoder	Bashkia Malësi e Madhe	55
Shkoder	Bashkia Malësi e Madhe	5
Tirane	Bashkia Tiranë	3
Tirane	Bashkia Tiranë	1
Tirane	Bashkia Tiranë	11
Tirane	Bashkia Tiranë	1
Tirane	Bashkia Tiranë	3
Tirane	Bashkia Tiranë	2
Tirane	Bashkia Tiranë	2
Tirane	Bashkia Kamëz	2
Tirane	Bashkia Tiranë	1
Tirane	Bashkia Tiranë	2
Tirane	Bashkia Tiranë	1
Tirane	Bashkia Tiranë	9
Tirane	Bashkia Tiranë	8
Tirane	Bashkia Vorë	3
Tirane	Bashkia Tiranë	2
Tirane	Bashkia Tiranë	1
Tirane	Bashkia Kavajë	1
Tirane	Bashkia Rrogozhinë	4
Tirane	Bashkia Rrogozhinë	2
Tirane	Bashkia Rrogozhinë	4
Vlore	Bashkia Vlorë	2
Vlore	Bashkia Selenicë	3
Vlore	Bashkia Vlorë	33
Vlore	Bashkia Sarandë	2
	TOTALI	**727**

Aneks 4

Statistikat për zgjedhësit e përjashtuar për shkak të kufizimeve ligjore

Qarku	Bashkia	Numri
Elbasan	Bashkia Belsh	2
Berat	Bashkia Berat	2
Diber	Bashkia Bulqizë	5
Elbasan	Bashkia Cërrik	13
Vlore	Bashkia Delvinë	14
Korce	Bashkia Devoll	15
Diber	Bashkia Dibër	17
Fier	Bashkia Divjake	6
Durres	Bashkia Durrës	44
Elbasan	Bashkia Elbasan	50
Fier	Bashkia Fier	85
Vlore	Bashkia Finiq	2
Shkoder	Bashkia Fushë - Arrëz	6
Gjirokaster	Bashkia Gjirokastër	23
Elbasan	Bashkia Gramsh	8
Kukes	Bashkia Has	4
Tirane	Bashkia Kamëz	26
Tirane	Bashkia Kavajë	6
Gjirokaster	Bashkia Kelcyre	2
Diber	Bashkia Klos	2
Korce	Bashkia Kolonjë	1
Vlore	Bashkia Konispol	2
Korce	Bashkia Korçë	60
Durres	Bashkia Krujë	22
Kukes	Bashkia Kukës	12
Lezhe	Bashkia Kurbin	43
Lezhe	Bashkia Lezhë	50
Gjirokaster	Bashkia Libohove	1
Elbasan	Bashkia Librazhd	3
Fier	Bashkia Lushnje	23
Shkoder	Bashkia Malësi e Madhe	16

Korce	Bashkia Maliq	23
Fier	Bashkia Mallakaster	11
Diber	Bashkia Mat	12
Gjirokaster	Bashkia Memaliaj	7
Lezhe	Bashkia Mirditë	29
Fier	Bashkia Patos	24
Elbasan	Bashkia Peqin	9
Gjirokaster	Bashkia Përmet	3
Korce	Bashkia Pogradec	25
Elbasan	Bashkia Prrenjas	6
Shkoder	Bashkia Pukë	6
Tirane	Bashkia Rrogozhinë	5
Fier	Bashkia Rroskovec	6
Vlore	Bashkia Sarandë	16
Vlore	Bashkia Selenicë	13
Durres	Bashkia Shijak	9
Shkoder	Bashkia Shkodër	92
Berat	Bashkia Skrapar	2
Gjirokaster	Bashkia Tepelenë	14
Tirane	Bashkia Tiranë	153
Kukes	Bashkia Tropojë	13
Berat	Bashkia Ura Vajgurore	1
Shkoder	Bashkia Vau i Dejës	19
Vlore	Bashkia Vlorë	47
Tirane	Bashkia Vorë	4
	TOTALI	**1114**

Aneks 5

Statistikat për qendrat e Votimit pë Institucionet e Posaçme

Nr	Kodzgjc	Kodqv	Njësia	Bashkia	Qarku	Adresa	ZAZ	Zgjedhës
1	8	3433-00	Njesia Administrative Otllak	Bashkia Berat	Berat	Parangoi,Dyshnik,(godina e paraburgimit)Sipas vendimit të Kryetarit të Bashkisë Nr.476 Dt.28.04.2017.	ZAZ 64	70
2	48	0938-02	Njesia Administrative Burrel	Bashkia Mat	Diber	Burgu Burrel	ZAZ 16	113
3	54	1008-00	Njesia Administrative Lis	Bashkia Mat	Diber	Burgajet, Shkolla	ZAZ 16	609
4	86	1292-01	Njesia Administrative Fushe Kruje	Bashkia Krujë	Durres	F - Kruje , Blloku Nr.1	ZAZ 20	175
5	99	2391-00	Njesia Administrative Bradashesh	Bashkia Elbasan	Elbasan	Palestra e paraburgimit IEVP Elbasan	ZAZ 47	144
6	100	2565-01	Njesia Administrative Fierze	Bashkia Belsh	Elbasan	Kosove+Burgu 2565/1	ZAZ 45	21

7	100	2565-00	Njesia Administrative Fierze	Bashkia Belsh	Elbasan	Kosove+Burgu 2565/1	ZAZ 45	829
8	131	2273-02	Njesia Administrative Peqin	Bashkia Peqin	Elbasan	Lagjia "Teqe", I.E.V.P. Peqin	ZAZ 44	42
9	222	4383-01	Njesia Administrative Qendër _ TEPELENE	Bashkia Tepelenë	Gjirokaster	Klasa e edukimit burgu Bënçë	ZAZ 77	67
10	239	3707-01	Njesia Administrative Drenovë	Bashkia Korçë	Korce	Drenovë, Burgu	ZAZ 71	245
11	278	0637-01	Njesia Administrative Kukës	Bashkia Kukës	Kukes	Shtepia e Oficerave	ZAZ 11	68
12	316	0748-01	Njesia Administrative Shënkoll	Bashkia Lezhë	Lezhe	I.E.V.P (Burgu) Shenkoll	ZAZ 13	341
13	373	1680-00	Njesia Administrative Nr. 1	Bashkia Tiranë	Tirane	Shtepia e te Moshuarve	ZAZ 31	46
14	373	1690-00	Njesia Administrative Nr. 1	Bashkia Tiranë	Tirane	IEVP "Ali Demi"	ZAZ 31	48

15	381	1967-00	Njesia Administrative Nr. 9	Bashkia Tiranë	Tirane	Burgu 302	ZAZ 39	192
16	381	1967-01	Njesia Administrative Nr. 9	Bashkia Tiranë	Tirane	Burgu 313	ZAZ 39	491
17	405	2224-01	Njesia Administrative Rrogozhinë	Bashkia Rrogozhinë	Tirane	Burgu Rrogozhinë	ZAZ 43	167
18	419	4451-00	Njesia Administrative Vlorë R5	Bashkia Vlorë	Vlore	Paraburgimi	ZAZ 83	161
19	433	4678-00	Njesia Administrative Sarandë	Bashkia Sarandë	Vlore	Paraburgimi Sarandë	ZAZ 88	46